

Tiranë më, 27.05.2024

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" UNION FINANCIERE" SH.P.K

Sot në date 27.05.2024, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë ortakët :

- **Z. Gavino Gadau** , i datëlindjes 01.08.1952, i lindur në Porto Torres , Itali dhe banues në ” 3rd Floor East, 12 Bridewell Place London EC4V 6AP ,GB” , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i Pasaportes me numër: 124557787.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqipëtar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është " **UNION FINANCIERE**" SH.P.K

Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë është në adresën Rruga e Barrikadave, Banesa tek ish Kinema 17 Nentori, (Galeria), Kati i trete, Tiranë .

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë 10 vjecare.



Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

- Investime tregtare.
- Bashkëpunim, pjesëmarrje dhe tregtim në fushën e industrisë ose të imobiliareve në të gjithë botën.
- Ndermjetësim financiar
- Shitje-blerje të pasurive mobilare
- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë

Neni 5 – Kapitali themeltar

- Kapitali aksioner i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
- Kapitali nënshkruhet dhe shlyhet plotësisht nga aksionari i shoqërisë **Z. Gavino Gadau** me vlerë 100 000 (njëqind mijë), përkatësisht 100% (njëqind për qind) e kapitalit të shoqërisë.
- Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin e saj deri në kufirin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve (aksionari i vetëm).
- Karta e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga një aksion, me vlerë 100 000 (njëqind mijë).

Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Neni 7- Administratorët

Me këtë Akt emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Gavino Gadau** , i datëlindjes 01.08.1952, i lindur në Porto Torres , Itali dhe banues në " 3rd Floor East, 12 Bridewell Place London EC4V 6AP ,GB", madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i Pasaportes me numër: 124557787.

Neni 8 – Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9 – Gjuha

Ky akt sipas legjislacionit për institucionin përbëhet nga 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe ne 2 (dy) kopje ne gjuhen italiane që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAËT E SHOQËRISË

" UNION FINANCIERE" SH.P.K

Z.Gavino Gadau

GAVINO GADAU
